

UDHËZIM
Nr.18, datë 11.10.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E KQZ-SË NR.9, DATË 20.9.2003 “MBI
PROCEDURAT E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE ADMINISTRIMIN E FLETËVE TË
VOTIMIT NGA KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Në udhëzimin e KQZ-së nr.9, datë 20.9.2003 “Mbi procedurat e numërimit të votave dhe administrimin e fletëve të votimit nga komisioni i qendrës së votimit” të bëhen këto shtesa:

1. Në nenin 21 “vota të vlefshme e të pavlefshme për kandidatët për kryetar” pika (i) bëhet si më poshtë:

“Kryetari dhe anëtarët e tjerë të KQV-së numërojnë votat e pavlefshme për kandidatët për kryetar dhe i shënojnë ato në procesverbal dhe në tabelën e rezultateve. Pas kësaj numërojnë votat e vlefshme që ka marrë çdo kandidat për kryetar dhe i shënojnë ato në procesverbal dhe në tabelën e rezultateve. Numri i votave të vlefshme për kandidatët për kryetar duhet të jetë i njëjtë me shumën e votave të vlefshme që ka marrë secili nga kandidatët për kryetar.”.

2. Në nenin 22 “vota të vlefshme e të pavlefshme për listat shumemërore” pika (i) bëhet si më poshtë:

“Kryetari dhe anëtarët e tjerë të KQV-së numërojnë votat e pavlefshme për listat shumemërore dhe i shënojnë ato në procesverbal dhe në tabelën e rezultateve. Pas kësaj numërojnë votat e vlefshme që ka marrë çdo listë shumemërore dhe i shënojnë në procesverbal dhe në tabelën e rezultateve. Numri i votave të vlefshme për listat shumemërore duhet të jetë i njëjtë me shumën e votave të vlefshme që ka marrë secila nga listat shumemërore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.